



Në bazë të nenit 29 të Ligjit mbi planifikimin dhe rregullimin e hapsirës (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 2/89), nenit 3 të Rregulloresë mbi Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës nr.2000/45 dhe nenit 19 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 03.04.2003 merr

**V E N D I M**  
**MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E**  
**PLLAKËS PËRKUJTIMORE TË DËSHMORËVE TË KOMBIT NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve të Kombit në Prishtinë:

- Isë Kastrati,
- Sokol Sopi,
- Afrim Vitia.

Lokacioni nga alinea 1 e këtij neni përfshin sipërfaqen prej 40 m<sup>2</sup> në pjesën e ngastrës kadastrale nr.7748, Komuna Kadastrale Prishtinë, pronë komunale-sipërfaqe publike.

**Neni 2**

Ky Vendim paraqet bazë për përgatitjen e dokumentacionit teknik në nivel të projektit urbanistik i cili do të shërbejë si bazë për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike për rregullimin e hapsirës për ndërtimin e Pllakës Përkujtimore nga neni 1 i këtij vendimi.

**Neni 3**

Drejtorati i Kadastrit dhe Gjeodezisë do të kryejë veprime procedurale nga përgjegjësia e tij për shënimin e lokacionit të caktuar sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Bordi i Drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01 Nr.353-504 Data: 09.04.2003**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**